



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati në Konferencën vjetore të ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve të Vishegradit dhe Ballkanit Perëndimor

2017-10-11 15:10:00



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, mori pjesë në Konferencën vjetore të Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve të Vishegradit (Hungari, Poloni, Çeki, Sllovaki) dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Ky takim u zhvillua në Budapest në kuadrin e Presidencës hungareze të Grupit të Vishegradit. Në takim morën pjesë edhe Ministrat e Punëve të Jashtme të Rumanisë, Bullgarisë si dhe përfaqësues të Estonisë, Kroacisë, Sllovenisë.

Diskutimet u përqendruan në identifikimin e hapave për përsheptimin e procesit të zgjerimit të BE-së në rajon, jo vetëm si një ushtrim teknik, por edhe si një instrument në përballjen me sfidat e sigurisë në Evropë.

Në mënyrë specifike për vendin tonë, vendet e grupit të Vishegradit shprehën mbështetjen për caktimin sa më shpejt të një date për fillimin zyrtar të negociatave për aderimin në BE. Ata vlerësuan progresin e Shqipërisë, sidomos për reformën e sistemit të drejtësisë dhe kërkuan që ky progres të reflektohet qartë në vendim-marrjen e BE-së.

Ministri Bushati, në fjalën e tij, vlerësoi si tepër të rëndësishëm rolin e vendeve të Vishegradit dhe mbështetjen e tyre në mënyrë që angazhimi i shprehur së fundmi nga BE ndaj procesit të zgjerimit të përkthehet në hapa konkretë.

Ministri nënvizoi rëndësinë e vijimit të agjendës së zgjerimit si një element thelbësor për rajonin tonë por edhe për vetë BE-në. Duke informuar mbi progresin e vazhdueshëm në zbatimin e reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare, ministri Bushati theksoi se, "zbatimi i ligjit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është hapi kyç për të vijuar me vendosmëri në procesin e hapjes së bisedimeve për anëtarësim me Bashkimin Evropian".